



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Udhëzimet për heqjen ose uljen e gjobës

Vëllimi i zbatimit të Udhëzimeve për heqjen ose uljen e gjobës

1. Me këto Udhëzime rregullohen detajet se si Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtutjeshëm:KVK) do të veprojë sipas kërkesave për heqjen ose uljen e gjobës për ndërmarrjet.
2. Politika e heqjes ose uljes së gjobës u jep mundësi ndërmarrjeve të përfshira në kartel që vetë do të paraqiten dhe do ti dorëzojnë dëshmitë, tërësisht tua heq gjobat ose ti ulë gjobat, që KVK përndryshe do tua shqiptonte të njëjtave.

Heqja e gjobës

3. KVK do të përcaktojë heqjen e gjobës ne bazë të nenit 65 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës(Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 145.10, 136/11, 41/14 dhe 53/16) dhe në pajtim me Rregulloren për kushtet më të përafërta për heqjen ose uljen e gjobës dhe procedurës sipas të cilës KVK vendos për heqjen ose uljen gjobës (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 41/12), në qoftë se ndërmarrja:
 - a) është e para e cila do të sigurojë KVK-së dëshmi/të dhëna dhe informacione (ose i jep informacion në lidhje me vendndodhjen e provave relevante që KVK mund ti merr në vendngjarje), ku provat janë të mjaftueshme që KVK:
 - të inicioj procedurë kundërvajtës në lidhje me kartelin që është në shqyrtim ose
 - procedurën kundërvajtës që tashmë është iniciuar ta përfundojë me një vendim me të cilën vërtetohet ekzistimi i kundërvajtjes;
 - b) nuk ka marrë masa me të cilën detyroi një ndërmarrje tjetër të merr pjesë ose të mbetet në një kartel dhe
 - c) gjatë procedurës bashkëpunon me KVK-në në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme.
4. Një ndërmarrje mund të konsiderohet se detyron ndërmarrje të tjera të marrin pjesë ose të mbeten në një kartel, nëse ka prova që tregojnë qartë që ndërmarrja që kërkon heqjen e gjobës ka kryer presion, në një ndërmarrje tjetër/tjera, pjesëmarrës/e në kartel të merr pjesë në kartelin ose të mbetet në të njëjtën. Për këtë rast, KVK mund të caktojë vetëm uljen e gjobës.

Ulja e gjobës



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



5. Ndërmarrjes të cilës nuk mund ti caktohet heqje e gjobës, mund të kërkojë ulje të gjobës deri në 50%, nëse ndërmarrja:
 - a) i siguron KVK-së informacione shtesë me goje dhe me shkrim dhe prova të cilët janë me rëndësi vendimtare, të cilët i mundësojnë KVK-së të vërteton ekzistimin e kartelit dhe
 - b) bashkëpunon në mënyrë plotë dhe të vazhdueshme me KVK-në.
6. Kriter kryesor për përcaktimin e shumës së uljes së gjobave, do të jetë vlera e përgjithshme e shtuar e provave të dhëna nga parashtruesi i kërkesës për uljen e gjobave. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse provat e dhëna nga ndërmarrësi paraqesin prova me vlerë të konsiderueshme të shtuar në lidhje me provat që KVK-ja tashmë i ka. KVK, gjithashtu do të marrë parasysh nivelin e përgjithshëm të bashkëpunimit.

Kushtet për heqjen ose uljen e gjobave

7. Në të gjitha rastet, ndërmarrja që ka dorëzuar kërkesë për heqjen ose uljen e gjobës, duhet në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme të bashkëpunojë KVK-në gjatë vijimit të procedurës. Qasja e përgjithshme në procesin e heqjes ose uljen e gjobës nga parashtruesi i kërkesës duhet të jetë konstruktiv, me qëllim që me të vërtetë të ndihmojë KVK-në në zbulimin efikas dhe efektiv, hetimin dhe marrjen e masave për të provuar ekzistencën e një karteli.
8. Ndërmarrja duhet të ndërpresë shkeljen (pjesëmarrjen e saj në kartel) menjëherë, përveç në rastet kur KVK konsideron që pjesëmarrje e mëtutjeshme e saj në kartel është domosdoshme për përfundimin e suksesshëm të procedurës(për shembull për të mbrojtur elementin e papritur gjatë mbledhjes së ardhshme të paparalajmëruar të provave në vendngjarje nga KVK).
9. Ndërmarrja duhet të sigurojë KVK-së të gjitha informatat relevante dhe dëshmitë që i posedon.
10. Bashkëpunimi duhet të jetë me kohë, të dhënat të dorëzohen menjëherë dhe punonjësit aktual (nëse është e mundur edhe ish-punonjësit) të jenë në dispozicion për KVK-në për të dhënë intervista ose deklarata të dëshmitarëve që janë në përputhje me kërkesat e arsyeshme të KVK-së. Parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë emrin e të gjithë punonjësve të përfshirë në kartel (përfshirë edhe ish-punonjësit) dhe të sigurojë që të gjithë të punësuarit nga të cilat do të kërkohet informata dhe dëshmi, plotësisht dhe në mënyrë të vazhdueshme do të bashkëpunojnë me KVK-në gjatë procedurës. Nëse parashtruesi i kërkesës parashikon ose përballet me vështirësi në përmbushjen e a fatit të fundit ose kërkesave të KVK-së, është e nevojshme të informon KVK-në së më shpejtë të jetë e mundur.
11. Bashkëpunimi me KVK-në nënkupton që sipas rregullit ndërmarrja nuk guxon të zbulon përmbajtjen e kërkesës për heqjen ose uljen e gjobave deri në dorëzimin e njoftimit preliminar për gjendjen e vërtetuar faktike nga KVK. KVK dhe ndërmarrja mundet edhe ndryshe të merren vesh.
12. Ndërmarrja nuk guxon të asgjëson, fsheh ose falsifikon informata relevante ose dëshmi.

Procedura



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Kontaktet para parashtrimit të kërkesës

13. Ndërmarrjet ose personat që kanë për qëllim të parashtrojnë kërkesë për heqjen ose uljen e gjobave, kanë mundësi, para se të veprojnë kështu, ti drejtohen KVK-së për të marrë udhëzimet në lidhje me parashtrimin e kërkesës dhe besueshmërisë për të gjithë procesin. Bisedimet për dhënien e udhëzimeve për besueshmëri mund të mos përfshijnë caktimin e një gjendje faktike (mund të përdoret termin „hipotetike”) me qëllim që ndërmarrjet dhe personat të ndihen komod para se të marrin një vendim për dorëzimin e kërkesës.
Çdo person që ka për qëllim të parashtroj kërkesë për heqjen ose uljen e gjobave nga KVK, mund të paraqitet në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës në tel: ++389 2 3 298 666 ose të paraqitet në zyrat e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe të kërkon të bisedon me një person zyrtarë.
14. KVK nuk do ti përdor për asnjë qëllim tjetër të dhënat e marra në kontaktet para parashtrimit të kërkesës. Në rast kur nuk do të lejohet heqja ose ulja e gjobave, KVK nuk do të publikon identitetin e ndërmarrjeve.
15. Me qëllim që të kenë përfitime nga Udhëzimet, ndërmarrjet mund të drejtohen në KVK drejtpërdrejt , ose përmes përfaqësuesve të tyre ligjor.

Parashtrimi i kërkesës për heqjen ose uljen e gjobave

KVK rekomandon gjatë parashtrimit të kërkesës së pari të realizohet kontakti me një persona zyrtar nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Kërkuarat për heqjen e ose uljen gjobave mund të dorëzohen:

- personalisht në arkivin e Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës
- përmes e-mail adresën në leniency@kzk.gov.mk
- përmes postës së rekomanduar në adresën: Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, 1000 Shkup (në këtë rast rekomandohet në zarf të shënohet koha e dërgimit të dokumentit).

Në rast të dorëzimit të kërkesës përmes e-mail adresës, kërkesa origjinale duhet të dorëzohen në arkivin e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës në afat prej 3 ditëve.

Për më shumë informata rreth programit, parashtruesit e kërkesave mund të na kontaktojnë në tel ++389 2 3298 666 në periudhën prej 09:30 deri 15:30 gjatë ditëve të punës.

Vërtetim



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



16. Ndërmarrja mund të kontaktoj KVK-në për të shpreh gatishmërinë e saj të bashkëpunimit (njoftim me qëllim të parashtrimit të kërkesës për heqjen gjobës) ku KVK do të japë një vërtetim-shënues. Vërtetimi paraqet një konfirmim formal me shkrim për pranimin e kërkesës për heqjen e gjobës që mbron vendin e parashtruesit të listës për pritje për një periudhë të caktuar në lidhje me parashtruesit e tjerë. Për marrjen e vërtetimit, KVK përcakton pragun relativist të ulët dëshmues. Gjithçka që është e nevojshme është të vendoset një bazë konkrete për dyshimin e veprimtarisë së kartelit dhe duke treguar një qëllim të vërtet për të pranuar ekzistimin e kartelit. Parashtruesit e kërkesës për heqjen ose uljen e gjobave janë të inkurajuar të kontaktojnë KVK-në sa më parë që është e mundur.
17. Në vërtetimin, KVK përcakton një periudhë kohore në të cilën parashtruesi i kërkesës duhet të dorëzojë kërkesën për heqjen e gjobës. Me përjashtim, me kërkesë të parashtruesit, nëse ka shkaqe të arsyeshme, KVK mund të vazhdojë afatin për dorëzimin e kërkesës.

Përmbajta e kërkesës

18. Në kërkesën për heqjen ose ulen e gjobës, parashtruesi duhet të paraqes një „ Deklaratë të ndërmarrjes” në përputhje me nenin 3 të Rregullores.
KVK thekson që, sipas definicionit, aktivitetet e kartelit kanë për qëllim parandalimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës, dhe për këtë arsye nga parashtruesi, nuk kërkohet që të dorëzohen dëshmi/të dhëna dhe informacione për vlerësimin e efekteve reale të aktivitetit të kartelit para se të vazhdohet me kërkesën.

Kërkesa e Grupit për heqjen e gjobës

19. KVK nuk do të pranojë kërkesë të grupit për heqjen ose uljen e gjobave, të bërë në të njëjtën kohë nga ana e ose në emër të dy ose më shumë ndërmarrjeve që marrin pjesë në të njëjtin kartel.

Deklarata me gojë

20. Kërkesa (duke përfshirë kërkesën për konfirmim) mund të jepet gojarisht dhe të evidentohet në procesverbal.
21. Koha kur organizohen takimet e KVK-së për deklarata me gojë janë prej orës 09:30 -15:30. Prania e parashtruesit jashtë orarit të punës do të lejohet vetëm në rrethana përjashtuese dhe në varësi të një marrëveshje paraprake me KVK-në .
22. KVK është e nevojshme të informohet mjaftueshëm (mundësisht 24 orë më parë) për organizimin e takimit. Parashtruesi duhet ti shënojë emrat e personave që do të marrin pjesë, pajisjet e nevojshme dhe kohëzgjatjen e takimit.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



23. “Deklaratat e ndërmarrjes” me gojë të nenit 3 të Rregullores duhet të jenë të qarta, faktike dhe të çojnë drejt qëllimit, me informacione të mjaftueshme të detajuara. Përshkrimi i kartelit përkatës mund të sigurohet gojarisht, ndërsa të dhënat e tjera si për shembull produkti ose përshkrimi i tregut, të dhënat kryesore të tregut dhe të gjitha informatat në dispozicion për publikun duhet të jenë të dorëzuara në formë të shkruar si një aneks në Deklaratë.
24. “Deklaratat e ndërmarrjes” me gojë të nenit 3 të Rregullores nuk mund të përmbajnë fshehtësi afariste ose zyrtare në kuptim të nenit 57 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës .
25. Aneksat e dorëzuara në deklaratën me gojë duhet të dorëzohen edhe në formë elektronike (në CD, DVD etj).
26. Në qoftë se nuk respektohen këto Udhëzime dhe Rregullorja, KVK mund të kërkojë nga parashtruesi të tërheqë këtë version të „Deklaratës së ndërmarrjes” dhe/ose përsëri të paraqesë „Deklaratën e ndërmarrjes” në një mënyrë që është në përputhje me këto Udhëzime dhe Rregulloren.

Statusi i parashtruesve

27. Nëse parashtruesi i parë i kërkesës nuk i përmbush të gjitha detyrimet (veçanërisht detyrimet që kanë të bëjnë me bashkëpunimin me KVK-në), ndërmarrja e humb vendin e saj të mbrojtur në listën për heqjen e gjobës dhe parashtruesi i ardhshëm i kërkesës për heqjen e gjobës merr vendin e parë të mbrojtur në listën për heqjen e gjobës.

Vërtetim me shkrim

28. KVK i jep vërtetim me shkrim parashtruesit të kërkesës për heqjen/uljen e gjobës, duke konfirmuar datën dhe kohën e pranimit të kërkesës sipas nenit 8, respektivisht nenit 12 të Rregullores.
Nëse kushtet për heqjen ose uljen e gjobës janë plotësuar, KVK-ja, me shkrim e njofton parashtruesin sipas nenit 9, respektivisht nenin 13 të Rregullores.

Kontroll i shkresave

29. KVK, me kërkesë të pjesëmarrësve në procedurë mund t’u lejon kontroll në _____, „ Deklaratën e ndërmarrjes”.